



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Data e marrëveshjes: 27. 11. 2023			
Numri i marrëveshjes: 01/2563			



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET

1. Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjilan me adresë në rr. "Zija Shemsiu, p.n., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku (në tekstin e mëtejme: UKZ);

dhe

2. "Albimi LTD", me numër unik identifikues: 810276007, me seli në Gjilan, Rr. "Lidhja e Prizrenit", përfaqësuar nga pronari: Ibrahim Krivaqa (në tekstin e mëtejme: Albimi)

Tani e tutje, bashkërisht referuar si "Palët", të cilat janë dakorduar si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i kushteve të bashkëpunimit ndërmjet palëve, mbi aftësimin praktik dhe punësimin të studentëve aktual dhe atyre të diplomuar, në UKZ, nga ana e Albimi-t.

Neni 2

Detyrimet e palëve

Palët marrin përsipër të përmbushin detyrimet si në vijim:

- a) UKZ, pas hapjes së një thirrje publike të bazuar në parimin e transparencës dhe barazisë, do të propozoj një listë të studentëve nga Fakulteti Ekonomik, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, me notë mesatare më të lartë se 8.0, ndërkaq Albimi do të përzgjedh kandidatët nga lista e propozuar.
- b) Albimi obligohet që pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, të pranoj një numër studentësh nga fakultetet e cekura si në pikën a) të këtij neni, në hapësirat e tij, dhe të bëjë sistematizimin e tyre në kompani.



- c) Palët kanë rënë dakord që çdo student do të aftësohet në punë praktike në Albimi, kohëzgjatje prej 2-3 muaj, gjatë periudhës specifike për të cilën dakordohen palët.
- d) Sa i përket pagesës për studentët të cilët vijojnë në praktikë, është çështje e dakordimit ndërmjet punëdhënësit dhe studentit nëse do të aplikohet kompensimi.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë dy (2) vjeçare duke filluar nga dita e nënshkrimit, deri sa palët t'a shkëpusin marrëveshjen e tillë. Nëse asnjëra palë, nuk e ndërpre bashkëpunimin 3 (tre) muaj para përfundimit të periudhës dy vjeçare, kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme edhe për dy vite të tjera.

Neni 4

Forca madhore

Asnjëra palë nuk është përgjegjëse për mungesë performance në rast të ndonjë rrethane të shfaqur që është jashtë kontrollit të arsyeshëm të palëve, duke përfshirë por mos kufizuar në katastrofa natyrore, akte lufte apo terrorizmi, greva, veprime apo vendime të qeverisë, pengesa të rrjetit të internetit.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

1. Kontrata hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.
2. Të gjitha njoftimet, ndryshimet eventuale, kërkesat apo pretendimet e palëve në lidhje me objektin e Marrëveshjes do të konsiderohet si të pranuar, vetëm nëse i drejtohen palës tjetër me shkrim.
3. Kjo Kontratë është përpiluar në 3 ekzemplarë, nga të cilat palët marrin nga një(1) kopje secila.



PILOT

PALET:

Për :

Universitetin Publik "Kadri Zeka"

Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku

Rektor



Për:

"Albimi LTD" SH.P.K.

Ibrahim Krivaqa

Pronar/CEO